



Kuvendi i Komunës Klinë

01 Nr prot. 06-32255 /2024

Datë: 24.09 /2024

Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024. Me kërkesën e Drejtorisë për Arsim si dhe me rekomandimin e KPF-së datës: 06.09.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur me datën: 20.09.2024 mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Arsim, për transfer të mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve Mallra dhe Shërbime, burimi i financimit (10) brenda programit Arsim dhe Shkencë
2. Transfer i mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve mallra dhe shërbime, burimi i financimit (10) bëhet si në vijim:
 - 2.1 Në kuadër të programit Arsim dhe Shkencë (920) nga nen programi Arsimi Fillor (93510), kodi funksional (0912), nga kategoria ekonomike e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime (130), shuma e mjeteve 35,000.00 €
 - 2.2 Nga nen programi Arsimi i Mesëm (94710), kodi funksional (0922), nga kategoria ekonomike e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime (130), shuma e mjeteve 12,360.00 €
3. Shuma e mjeteve financiare si në nenin 2 të këtij vendimi transferohen në nen programin Administrata (92090), kodi funksional (0980), në kategorinë ekonomike e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime (130), shuma e përgjithshme 47,360.00 €
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

MAPL;

Kryetari i Komunes;

Drejtoria për Arsim;

Zyra për Informim;

Arkivi.



**Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi**